



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURES
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 230 Prot.

Tiranë, më 16.02 2018

VENDIM Nr. 22, datë 18.01.2018

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.1, datë 18.01.2018, pasi shqyrtoi Raportin e sondazheve arkeologjike, në kuadër të *devijimit të tubacionit të Gazsjellësit Trans Adriatik (TAP)*, në RR-016, KM 195+540-KM 196+580, Petovë-subjekti "SPIECAPAG Shqipëria", realizuar nga shoqëri e licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k.

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin e sondazheve arkeologjike, në kuadër të *devijimit të tubacionit të Gazsjellësit Trans Adriatik (TAP)*, në RR-016, KM 195+540-KM196+580, Petovë-subjekti "SPIECAPAG Shqipëria", realizuar nga shoqëri e licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k.
2. Të vijojnë punimet e ndërtimit për Linjën e Gazsjellësit Trans Adriatik (TAP), duke kryer ndjekjen në mënyrë periodike ditore të punimeve të gërmimit, sipas akt-marrëveshjes tre palëshe, të lidhur më parë ndërmjet Subjektit "SPIECAPAG Shqipëria", shoqërisë së licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k. dhe ASHA, për këtë zonë.
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10 2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

MINISTRIA E KULTURES
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FLIRISHI

MINISTËR



SEKRETAR I KKA

RUDINA ZOTO